

Ne fokus/ Roland Peqini rinis stervitjen pas operacionit

nga AlbaniaSoccer

E martë, 12 Nentor 2013 21:53



Mbrojtësi Roland Peqini ka nisur stervitjen pas operacionit në gju. Mbrojtësi që shkelqeu tek Kukësi dhe luajti vetëm pak minuta me Tiranën ka rifilluar përgatitjet. Dy muaj pas dëmtimit në gju, Peqini ka filluar palester dhe terapi për të rimarrë veten. Mbrojtësi dëmtoi ligamentet dhe u detyrua të bënte një ndërhyrje kirurgjikale e cila për fatin e tij të mirë shkoi si duhet. Peqini dëshiron të rikthehet sa më shpejt duke shpresuar të jetë i gatshëm për skuadrën e Tiranës në muajin janar kur do të rinisë kampionati.